REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT
VITI 2026

Nr.	**Data e regjistrimit të kërkesës**	**Natyra e kërkimit**	**Objekti i kërkesës** ***(përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)***	**Përgjigje** ***(përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)***	**Data e kthimit të përgjigjes**	**Mënyra e përfundimit të kërkesës** ***(përgjigjja jepet e plotë / e kufizuar / e deleguar)***	**Tarifa**
124.	01.10.2026	Kërkesë për informacion	Në kuadër të një verifikimi mbi sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit shqiptar, lutem të na vini në dispozicion informacionin e mëposhtëm për rastet e vitit 2026, kur produkte me origjinë nga Shqipëria janë sinjalizuar në sistemin "RASFF" nga autoritetet e vendeve të tjera: 1. Cilat janë rastet e vitit 2026 kur produkte me origjinë nga Shqipëria janë sinjalizuar në "RASFF"? Për secilin rast, lutem të specifikoni produktin, operatorin ekonomik, shtetin që ka bërë njoftimin, arsyen e sinjalizimit dhe datën e njoftimit. 2. Çfarë mekanizmash dhe procedurash zbaton Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me qëllim për të mbrojtur konsumatorin shqiptar, kur një produkt ushqimor me origjinë nga	***Në përgjigje të pyetjes së parë***, nga verifikimet e kryera rezulton se për periudhën e vitit 2026, janë marrë njoftimet e mëposhtme: 1. Më datë 31.01.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.2026.0772 dhe numër reference 820099, të kategorisë *refuzim në kufi*, me temë: "*Mungesë e certifikatës shëndetësore në karkaleca dhe kallamarë të ngrirë me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është njoftuar për ndjekje nga Italia. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "C****", me aktivitet tregtar: "*Stabiliment përpunimi dhe standardizimi peshku*", ka realizuar një eksport drejt Italisë, për subjektin importues "M** S.p.A.", më datë 22.11.2025, me certifikatë veterinare përkatëse importi nr.2025.0001813. Në këtë ngarkesë, si pasojë e një gabimi njerëzor, nga punonjësit e magazinës janë futur gabimisht edhe 2 *(dy)* paleta shtesë me LOT: 17 LR, me peshë neto 792 kg dhe peshë bruto 1,000 kg, të cilat ishin përgatitur nga OBU-ja për eksportin e radhës tek i njëjti importues, në paketim 5 kg. Për këtë arsye, këto paleta nuk	14.10.2026	e plotë	nuk ka

			Shqipëria konstatohet jashtë vendit se paraqet një problem të sigurisë ushqimore? Lutem të shpjegoni konkretisht hapat që ndërmerren pas marrjes së një njoftimi nga sistemi "RASFF". 3. Si verifikon Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nëse produkti i sinjalizuar, e njëjta ngarkesë ose produkte të tjera të të njëjtit operator, janë të pranishme në tregun shqiptar? 4. Nëse produkti është i pranishëm në tregun shqiptar, cilat janë masat që mund të ndërmerren për mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë bllokimin, tërheqjen nga tregu, asgjësimin, njoftimin e publikut apo masa të tjera? 5. A ka pasur gjatë vitit 2026, raste kur një produkt i sinjalizuar në "RASFF", është konstatuar edhe në tregun shqiptar? Nëse po, lutem të specifikoni produktin, problematikën dhe masat e marra. 6. Për rastet e sinjalizuara në sistem përgjatë vitit 2026, sa gjoba janë vendosur ndaj operatorëve ekonomikë shqiptarë si rezultat i problematikave të konstatuara dhe cila është vlera totale e këtyre gjobave? 7. Lutem të specifikoni edhe masën e gjobës për secilin rast.	ishin të përfshira në certifikatën veterinare të datës 22.11.2025. LOT-i nr. 17 LR është kthyer nga importi në vendin e origjinës më datë 29.01.2026, me CHEDP.IT nr. 2025.048712, për mungesë të dokumentacionit shoqërues. Trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, verifikoi dokumentacionin e gjurmueshmërisë për LOT-in 17 LR, përfshirë dokumentacionin e lëndës së parë, *kallamar dhe karkalec*, skedat teknike të prodhimit të produktit *Spiedini* (karkaleca dhe kallamarë të ngrirë), diagramën e fluksit dhe skedat e monitorimit të frigoriferëve. Për sasinë prej 792 kg peshë neto /1,000 kg peshë bruto, u morën mostra për analiza të treguesve mikrobiologjikë, rezultatet e të cilave rezultuan konforme me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në këto kushte, **pas daljes së rezultateve konforme**, produkti pati si destinacion tregun vendas; 2. Më datë 19.02.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.2026.1370 dhe numër reference 822683, të kategorisë *njoftim informues për vëmendje*, me temë: "*Prani e parazitit Anisakis në fileto açugesh me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është njoftuar për ndjekje nga Italia. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "K*********", me aktivitet tregtar: "*Stabiliment përpunimi dhe standardizimi peshku*", ka kryer eksportin e produktit. Nga verifikimet e kryera nga trupa inspektuese e Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Elbasan (DRAKU Elbasan), lidhur me *gjurmueshmërinë* e produkteve të subjektit,			

				rezultoi se produkti fileto açuge, me LOT: L329R dhe datë skadence 28.05.2027, ishte prodhuar nga lëndë e parë e importuar nga Spanja, nëpërmjet firmës "R**E** SPA", dhe ishte eksportuar drejt Italisë më datë 29.11.2025, me faturë nr.298 dhe certifikatë eksporti nr.2025-001426-48. Gjatë inspektimit të datës 20.02.2026, u morën dy mostra për analizimin e pranisë së parazitit *Anisakis*: 540 kg produkt gjysmë i gatshëm, me LOT: 017K dhe datë skadence 17.01.2027, si dhe 133 kg açuge në vaj, me LOT: 021K dhe datë skadence 28.07.2027. Sipas raporteve të provave të ISUV-së nr. D-92-26 dhe D-93-26, datë 23.02.2026, të dyja mostrat rezultuan me prani të *Anisakis*. **Për rrjedhojë, sasitë përkatëse u bllokuan nga trupa inspektuese, me destinacion asgjësimin**. Nga verifikimi i gjurmueshmërisë rezultoi se produktet ishin përftuar nga përpunimi i açuges së kriposur të importuar nga Spanja. Gjithashtu, u konstatua se subjekti dispononte regjistra për monitorimin e *histaminës* dhe *Anisakis*, por nuk kishte kryer analiza laboratorike për këtë parazit në kuadër të autokontrollit, duke deklaruar se nuk kishte konstatuar praninë e tij gjatë kontrollit vizual. Pas marrjes së rezultateve laboratorike, në datat 25–26.02.2026 u krye një inspektim tjetër, gjatë të cilit u verifikua gjendja e produkteve të bllokuara dhe gjurmueshmëria e lëndës së parë. Nga një sasi tjetër prej 96 kg fileto açuge, me LOT: 054K dhe datë skadence 28.08.2027, u mor gjithashtu mostër për analizim, e cila rezultoi konforme, pa prani të parazitit			

				Anisakis. **Në përfundim**, nga analizat laboratorike u konfirmua prania e parazitit *Anisakis* në produktet me LOT: 017K dhe LOT: 021K, përkatësisht në sasitë 540 kg dhe 133 kg, të cilat u bllokuan me destinacion asgjësimin. Ndërsa produkti me LOT: 054K, në sasinë 96 kg, rezultoi konform, pa prani të parazitit. Gjithashtu, u evidentua se subjekti nuk kishte kryer analiza laboratorike për *Anisakis* në kuadër të autokontrollit, pavarësisht se dispononte regjistrin përkatës të monitorimit; 3. Më datë 18.06.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.851980 dhe numër reference 2026.5324, të kategorisë *refuzim në kufi*, me temë: "*Acetamiprid në speca të kuq me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "R****** SHPK, me aktivitet tregtar: "*Grumbullim, shpërndarje/eksport frutash, perimesh*", ka kryer eksportin e produktit "*Spec*" *(spec babur, klasi II)*, me destinacion Kroacinë; 4. Më datë 26.06.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.853593 dhe numër reference 2026.5598, të kategorisë *alert*, me temë: "*Nivele mbi normë të Fluopyram dhe Tebufenpyrad në speca babur me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "H**** SHPK, me aktivitet tregtar: "*Grumbullim, shpërndarje/eksport frutash, perimesh*", ka kryer eksportin e produktit "*Spec*" *(spec babur)*, destinacion Sllovenинë;			

				5. Më datë 08.09.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.870028 dhe numër reference 2026.7880, të kategorisë *refuzim në kufi*, me temë: "*Acetamiprid në speca me origjinë nga Shqipëria, nëpërmjet Maqedonisë së Veriut*", në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "A**********", me aktivitet tregtar: "*Grumbullim, shpërndarje/eksport frutash, perimesh*", ka kryer eksportin e produktit "*Spec*" *(spec i kuq)*, me destinacion Kroacinë; 6. Më datë 09.09.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.871532 dhe numër reference 2026.7900, të kategorisë *refuzim në kufi*, me temë: "*Proquinazid në speca të kuq me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "M**S**", me aktivitet tregtar: "*Grumbullim, shpërndarje/eksport frutash, perimesh*", ka kryer eksportin e produktit "*spec i kuq*", destinacion Kroacinë. 7. Më datë 10.09.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.734086 dhe numër reference 2026.7962, të kategorisë *refuzim në kufi*, me temë: "*Flonicamid dhe Acetamiprid në speca me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është etiketuar për vëmendje. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "N**** F*****" SHPK, me aktivitet tregtar: "*Grumbullim, shpërndarje/eksport frutash, perimesh*", ka kryer eksportin e produktit "Spec Babur", me destinacion Kroacinë; 8. Më datë 24.09.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.874886 dhe numër reference 2026.8432, të kategorisë *refuzim në*			

				kufi, me temë: "*Flonicamid në speca të kuq me origjinë nga Shqipëria*". Në referim të këtij njoftimi, subjekti "M**S**", me aktivitet tregtar: "*Grumbullim, shpërndarje/eksport frutash, perimesh*", ka kryer eksportin e produktit "*Spec i kuq*", destinacion Kroacinë; 9. Më datë 23.09.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.874492 dhe numër reference 2026.8375, të kategorisë *njoftim informues për vëmendje*, me temë: "*Histaminë mbi normat e lejuara, në fileto açugesh në vaj me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje. Në referim të këtij njoftimi, ky rast është trajtuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Konkretisht, produkti i rezultuar jokonform, me prani të treguesit histaminë, ishte "*Filetti di alici in olio*" *(fileto açugesh në vaj),* me datë skadence 16.12.2027 dhe LOT LVS157. Subjekti shqiptar që e ka eksportuar produktin, "P**" SHPK, operon me import të produktit gjysmë të gatshëm nga një kompani e huaj dhe eksport të produktit të gatshëm po tek kompania e huaj; 10. Më datë 01.10.2026, sistemi "RASFF" ka nxjerrë njoftimin me nr.876612 dhe numër reference 2026.8660, kategori *refuzim në kufi*, me temë: "*Mbetje e pesticidit proquinazide në speca me origjinë nga Shqipëria*", në të cilin Shqipëria është etiketuar për vëmendje. Në referim të këtij njoftimi, subjekti "E*" SHPK, aktivitet: "*Grumbullim, shpërndarje/eksport frutash, perimesh*", ka kryer eksportin e produktit "Spec i kuq", me destinacion Kroaci.			

				Në përgjigje të pyetjes së dytë, duke iu referuar njoftimit të ardhur nga sistemi "RASFF" si dhe sipas qarkut ku Operatori i Biznesit Ushqimor (OBU) ka kryer eksportin, drejtoria rajonale përkatëse e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU), kryen inspektimin pranë subjektit eksportues me qëllim ndjekjen e gjurmueshmërisë, verifikimin me anë të faturave të gjithë sasisë së eksportuar për produktin (sipas njoftimit), si dhe vendet ku është eksportuar, sasinë gjendje, sasinë e shitur, nëse ky subjekt ka shpërndarë produktin në tregun vendas (në subjekte të tjera), si dhe evidentimin e fermerit/ëve prodhues. Në rast se rezulton që produkti i njoftuar, të jetë shpërndarë nga këto të fundit tek subjektet e tjera (bazuar në faturat tatimore të shitjes), merren masa për kryerjen e njoftimit për tërheqjen/kthimin e produktit nga tregu me qëllim bllokimin dhe asgjësimin e tij, konform legjislacionit në fuqi, duke kryer kontrollet përkatëse në këto subjekte, si dhe afishimin e njoftimeve për konsumatorët në këto subjekte (për kthimin e produktit/eve të blera dhe të pakonsumuara, të cilat bllokohen dhe më pas asgjësohen konform legjislacionit në fuqi). Po kështu, duke u bazuar në faturën/at e blerjes së produktit ku evidentohet fermeri/ët përgjegjës, nga ana e DRAKU-së kompetente përgatitet një shkresë e cila i adresohet *për ndjekje* drejtorisë rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të AKVMB, Tiranë.			

				Me marrjen e njoftimit nga sistemi "RASFF", brenda strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DPAKU), ndiqet një procedurë e brendshme, konkretisht: *Sektori i Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF* njofton *Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar* si dhe *Sektorin e Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU)*. Ky i fundit, adreson rastin pranë DRAKU-së kompetente lidhur me ndjekjen e mëtejshme. Në përfundim të gjithë procedurës që DRAKU ka ndjekur, njoftohet sërish Sektori i Koordinimit të Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OBU në DPAKU, lidhur me të gjitha gjetjet e konstatuara dhe masat e ndërmarra. Në referim të këtij informacioni që DRAKU përkatëse përcjell lidhur me rastin, Sektori i Koordinimit të Kontrolleve Zyrtare të Ushqimit për Kafshë dhe OBU, relaton një Memo informuese me qëllim përcjelljen e të gjithë informacionit edhe pranë Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sektorit të Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me sistemin RASFF në DPAKU, mbi konstatimet (gjetjet) dhe masat e ndërmarra. Ky njoftim dhe rakordim brenda institucionit, bëhet me qëllim që *Sektori i Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF* të njoftojë vetë sistemin "RASFF" me informacion shterues lidhur me rastin e ndjekur. ***Në përgjigje të pyetjes së tretë***, gjatë kontrollit zyrtar që trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar i Ushqimit ushtron pranë OBU-së eksportuese, kryhen verifikimet e		

				dokumentacionit shoqërues të produktit. Konkretisht, kontrollohet disponimi i *sistemit të gjurmueshmërisë* së produktit, si detyrim ligjor i cili normohet nga neni 25 i ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*. Pra, verifikohet origjina e produktit: faturat e blerjes nga subjekte të tjera tregtare, deri në evidentimin, bazuar në faturën përkatëse, të fermerit prodhues. Gjithashtu, verifikohet edhe gjurmueshmëria e shpërndarjes së produktit (faturat e shitjes) tek subjekte të tjera tregtare brenda vendit, për të njëjtin lot dhe për sasinë e eksportuar. P.SH.: Në rastin kur është konstatuar prania e treguesit të *histaminës* në produktin "*Filetti di alici in olio*" *(fileto açuge në vaj)*, me datë skadence 06.12.2027 dhe LOT LVS 157, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se produkti <u>nuk është hedhur në treg</u>. Sqarojmë se, në rastet kur konstatohet se një produkt eksporti i rezultuar jokonform është hedhur në treg, ndiqen të gjitha hapat për zbatimin e *sistemit të gjurmueshmërisë*, sipas ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)* dhe VKM-së nr.760, datë 16.09.2025 "*Për kërkesat për ushqimin dhe ushqimin për kafshë përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor*". ***Në përgjigje të pyetjes së katërt***, në rast se produkti, pjesë e lotit të eksportuar, është shpërndarë nga subjekti eksportues edhe tek subjekte të tjera, bazuar në faturat tatimore të shitjes dhe në kuadër të gjurmueshmërisë, trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, kryen kontrollet përkatëse në këto subjekte.			

				Gjatë këtyre kontrolleve verifikohet sasia e marrë, sasia e shitur dhe sasia gjendje, me qëllim bllokimin e produktit që ndodhet gjendje (nëse ka). Gjithashtu, kryhet njoftimi për tërheqjen/kthimin e produktit nga tregu, me qëllim bllokimin dhe asgjësimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe afishohen njoftimet për konsumatorët në këto subjekte, lidhur me kthimin e produktit të blerë dhe të pakonsumuar. Nëse produkti i eksportuar hidhet në tregun shqiptar, atëherë, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi dhe bazuar në dokumentacionin shoqërues të produktit, ndiqet gjurmueshmëria e tij. Në këtë kuadër, kryhen verifikimet përkatëse tek operatorët e biznesit ushqimor ku produkti është shpërndarë, duke verifikuar sasinë e marrë, sasinë e shitur dhe sasinë gjendje. Nëse konstatohet se ka sasi të produktit në gjendje, ato bllokohen me destinacion asgjësimin, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, pasi bëhet fjalë për një produkt jokonform. Lidhur me rastin e subjektit "K*F*", në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 46 të ligjit nr.99/2024 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", u bllokua produkti gjysmë i gatshëm në sasinë prej 540 kg , me Lot 017 dhe datë skadence 17.01.2027, *si dhe* sasia prej 133 kg e produktit të gatshëm *Fileto açuge në vaj* me Lot: 021K dhe datë skadence 28.07.2027, **të cilat shkojnë me destinacion asgjësimin, konform kërkesave ligjore.**			

				Në përgjigje të pyetjes së pestë, nga verifikimet e kryera, rezulton se në të gjitha rastet e lartpërmendura për vitin 2026, ka rezultuar se subjektet eksportuese nuk kryenin shitje të produkteve në tregun e brendshëm, por kryenin aktivitet tregtar vetëm për eksportin e tyre. ***Në përgjigje të pyetjeve 6 & 7***, për rastin e rezultuar me prani të parazitit *Anisakis* në produktin "*Filetto accughe në vaj ulliri*", me LOT L329 R dhe datë skadence 28.05.2027, të sinjalizuar në sistemin "RASFF" gjatë vitit 2026, nga trupa inspektuese e DRAKU Elbasan, në zbatim të nenit 68 "*Nxjerrja në treg e ushqimeve*", pika 1, gërma 'd' të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*, ndaj subjektit u mor masa administrative "*Gjobë*". Masa administrative "*Gjobë*", e vendosur nga trupa inspektuese e DRAKU Elbasan ndaj subjektit "K*F*", është në vlerën prej ALL 300,000 *(treqind mijë lekë)*, për nxjerrjen në treg të produkteve të pasigurta.			
125.	02.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me shoqërinë "A**" SHPK, specifikisht, për periudhën Janar 2020 deri në Shtator 2026: 1. Sa është sasia totale (në kilogramë ose ton) e mishit dhe nënprodukteve të mishit të skaduar që ky subjekt ka asgjësuar zyrtarisht nga Janari 2020 deri në Shtator 2026?	***Në përgjigje të pyetjes së parë***, sasia totale e mishit dhe nënprodukteve të mishit të nxjerra jashtë afateve të përdorimit, të cilën subjekti tregtar "A**" SHPK ka asgjësuar zyrtarisht nga periudha Janar 2020 - Shtator 2026, është në sasinë prej **93870 kg *ose* 93.870 ton**. ***Në përgjigje të kërkimit të dytë***, subjektit të interesuar iu vendos në dispozicion dokumentacioni: Praktikat e Inspektimit të bllokimit *dhe* asgjësimit të produkteve që i përkasin periudhës Janar 2020 - Shtator 2026.	07.10.2026	e plotë	nuk ka

			2. Lutem të na vini në dispozicion kopje të procesverbaleve zyrtare të bllokimit dhe të asgjësimit të këtyre produkteve. 3. Sa inspektime (të programuara dhe të paprogramuara) janë kryer nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, pranë fabrikës dhe thertores së këtij subjekti, gjatë kësaj periudhe dhe cilat kanë qenë gjetjet kryesore? 4. A janë konstatuar raste të rietiketimit të produkteve apo mbajtjes në mjediset e fabrikës të mishit të skaduar dhe nëse po, çfarë masash administrative janë marrë ndaj subjektit? 5. Lidhur me ngarkesën e mishit të importuar në Mars të vitit 2025 nga ky subjekt (ose subjekti i lidhur me "A* SHPK), e cila rezultoi e kontaminuar me bakterin '*Salmonella*': • Sa ishte sasia e saktë (në ton) e kësaj ngarkese që u bllokua dhe u asgjësua zyrtarisht? • Kopje të procesverbalit të asgjësimit, specifikisht për këtë rast të muajit Mars 2025. • Cilat kanë qenë masat administrative ose pezullimet e aktivitetit që AKU ndërmori ndaj subjektit pas konfirmimit të analizave?	***Në përgjigje të pyetjes së tretë***, për periudhën e kërkuar rezulton se pranë subjektit tregtar janë kryer **9** ***(nëntë)*** inspektime bazuar në Planin e Inspektimeve *dhe* **23** ***(njëzet e tre)*** inspektime të kryera jashtë Planit. Inspektimet e kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë qenë për licensimin; vlerësimin e kushteve higjieno-sanitare; marrje mostre; ku në procedurat e inspektimit të mbajtura nga trupat inspektuese, nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore. ***Në përgjigje të pyetjes së katërt***, nuk ka pasur asnjë rast ku të jetë konstatuar rast i rietiketimit të produkteve të mishit. ***Në përgjigje të pyetjes së pestë***, pranë subjektit tregtar, sasia e produktit të bllokuar, e cila rezultoi me prezencë të '*Salmonella Spp'*, është **3193 kg**, sasi kjo e cila është asgjësuar *(bashkëlidhur iu vendos në dispozicion, Procesverbali i asgjësimit të datës 09.04.2025).* Referuar Raport Provës jokonforme me nr.U-1352-25, datë 02.04.2025, për produktin "*Fileto Pule e marinuar*" me prezencë të '*Salmonella Spp*', janë marrë masat administrative konform legjislacionit në fuqi, si më poshtë: • Bllokim i linjës së prodhimit të produktit "*Fileto Pule e marinuar*"; *dhe* • Bllokim i produktit "*Fileto Pule e marinuar*", referuar Raport Provës jokonforme me nr.U-1352-25, datë 02.04.2025 —— me destinacion asgjësimin e këtij produkti.			

126.	05.10.2026	Kërkesë për vënie në dispozicion akti ligjor	Subjekti i interesuar parashtron se: Duke qenë se Shqipëria tashmë e ka harmonizuar legjislacionin kombëtar me Rregulloren e BE nr.1169/2011 për dhënien e informacionit rreth ushqimit për konsumatorët, kërkoj informacion nëse është kryer edhe ndonjë harmonizim i ngjashëm me Rregulloren e Komisionit Evropian(1333/2008) për aditivët ushqimorë. Nëse po, lutem të na siguroni listën e miratuar të aditivëve të lejuar.	Lidhur me informacionin e kërkuar, sqarojmë se Udhëzimi nr.18, datë 09.11.2022 "*Për aditivët ushqimorë të lejuar*", është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Bashkimit Evropian (BE) nr.1333/2008, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, "*Për aditivët ushqimorë*". Vendosur në dispozicion akti ligjor i kërkuar, me përditësimet përkatëse: Udhezim nr.18 date 9.11.2022 Per Aditivet ushqimore te lejuar.pdf	07.10.2026	e plotë	nuk ka
127.	06.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me: 1. Si janë të organizuara kontrollet që ushtroni në çerdhe dhe kopshte (private e publike), për të garantuar ushqim të sigurt për fëmijët? Konkretisht, cilat analiza kryeni, si e verifikoni cilësinë dhe sigurinë e ushqimit? 2. Çfarë rezultatesh keni arritur? 3. A ka patur penalizime? 4. Si procedoni kur ka shkelje? 5. A ka raste që janë nisur hetime edhe nga organet e drejtësisë? Keni referuar atje, rastet tuaja? 6. A keni patur denoncime nga prindërit? 7. Si bashkëpunoni me Ministrinë e Arsimit dhe Bashkinë? Si janë të ndara përgjegjësitë ndërmjet jush?	**Çerdhet dhe kopshtet (publike dhe private), klasifikohen si subjekte me risk të lartë dhe në zbatim të *Planit Vjetor të Inspektimeve*, kontrollohen me frekuencë 4 *(katër)* herë në vit, konkretisht, 1 *(një)* kontroll në çdo 3 *(tre)* muaj**. Gjatë kontrolleve zyrtare, AKU verifikon respektimin e kërkesave ligjore për sigurinë ushqimore, duke përfshirë kushtet higjieno-sanitare; ruajtjen dhe temperaturat e produkteve ushqimore; afatet e përdorimit; dokumentacionin; gjurmueshmërinë; si dhe zbatimin e praktikave të mira të higjienës e procedurave të bazuara në parimet e sistemit HACCP. ***Lidhur me analizat që kryhen***, AKU kryen analizat duke u bazuar në Planin Vjetor *të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave*, përfshirë edhe rastet emergjente. Konkretisht, kryhen analizat e lëndës së parë, në kuadër të kritereve të sigurisë ushqimore dhe kriteret e higjienës së prodhimit.	20.10.2026	e plotë	nuk ka

				Në varësi të kategorisë së produktit ushqimor dhe vlerësimit të riskut, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen *ose* dërgon për analizim laboratorik, mostra ushqimore për: • Analiza mikrobiologjike, për identifikimin e mikroorganizmave patogjenë dhe verifikimin e treguesve të higjienës; • Analiza fiziko-kimike, për verifikimin e parametrave përkatëse të sigurisë dhe cilësisë së produktit. Cilësia dhe siguria e ushqimit, verifikohen gjithashtu përmes kontrolleve zyrtare, dokumentacionit shoqërues, gjurmueshmërisë, afateve të përdorimit dhe kushteve të ruajtjes e të përgatitjes, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore. ***Lidhur me rezultatet e arritura dhe penalizimet***, nga verifikimet e kryera, rezulton se mostrat e dërguara për analizim laboratorik kanë rezultuar **konforme** me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Ndërsa, gjatë kontrolleve zyrtare, për mangësitë e konstatuara, janë marrë në total 6 *(gjashtë)* masa administrative "*Paralajmërim*", duke u lënë detyrë subjekteve përkatëse (Operatorëve të Biznesit Ushqimor) që të kryejnë korrigjimin e tyre, konkretisht, sistemimin e ambienteve të kuzhinës dhe largimin e pajisjeve jashtë funksionit, me qëllim përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare.			

				Në rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore për sigurinë ushqimore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vepron në përputhje me ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*, si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi. Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së shkeljes, merren masa për korrigjimin e mangësive; bllokimin e produkteve ushqimore jokonforme deri në asgjësimin e tyre; vendosjen e masave administrative ose ndërprerjen e aktivitetit, kur plotësohen kushtet ligjore. Gjithashtu, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen kontrolle pasuese për të verifikuar zbatimin e masave të përcaktuara. ***Lidhur me rastet e hetimeve dhe referimeve tek organet e drejtësisë***, nga verifikimet e kryera rezulton se nuk ka pasur raste të shkeljeve apo problematikave në fushën e sigurisë ushqimore, të konstatuara gjatë kontrolleve të kryera, të cilat të kenë çuar në referimin e informacionit pranë organeve të drejtësisë apo në nisjen e hetimeve nga këto organe. ***Në verifikim të denoncimeve të ardhura***, përgjatë vitit 2026, në mjetet e informimit publik të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, janë administruar 2 *(dy)* raste ankesash mbi problematikën e lartpërmendur. Konkretisht, 1 *(një)* ankesë është referuar nga një prind, lidhur me institucionin 'kopsht jopublik' në Sukth, Durrës, *ndërsa* 1 *(një)* ankesë tjetër është referuar nga Drejtoria e një shkolle publike në Mëzez, Tiranë, lidhur me një biznes ushqimor që ushtronte aktivitetin në perimetrin e shkollës. Në referim të këtyre denoncimeve, AKU mori masa për kryerjen e inspektimeve përkatëse.			

				Në përfundim të procedurave të inspektimit, *për rastin e parë* procedura është mbyllur pa shkelje të legjislacionit në fuqi, ndërsa, *për rastin e dytë* pas verifikimeve të kryera rezultoi se subjekti i denoncuar ishte i paregjistruar. Në këto kushte, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka marrë masat përkatëse, duke bashkëpunuar në rastin konkret për kompetencë ligjore me organet tatimore. Së fundmi, evidentojmë se përgjatë vitit 2026 janë marrë gjithashtu 2 *(dy)* njoftime, nga Komisariatet e Policisë në Korçë dhe Pogradec, për dyshime për raste të mundshme helmimi ushqimor në kopshte. Për këto raste, janë kryer verifikimet dhe inspektimet përkatëse, si dhe janë marrë mostra për analiza laboratorike për teste mikrobiologjike në Laboratorin ISUV. Në përfundim, rezultatet e mostrave të analizuara nga kopshtet Korçë dhe Pogradec, kanë rezultuar konform kërkesave ligjore. ***Për sa i përket bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; ministrisë përgjegjëse për arsimin; bashkitë; dhe institucionet e tjera përkatëse***, ky bashkëpunim realizohet përmes koordinimit ndërinstitucional, takimeve, shkëmbimit të informacionit dhe përcjelljes së problematikave të konstatuara gjatë kontrolleve zyrtare, me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore në institucionet që ofrojnë shërbim ushqimor për fëmijët. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të sigurisë ushqimore.			

				Në këtë kuadër, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit verifikon përmbushjen e kërkesave ligjore për higjienën, ruajtjen, përgatitjen dhe sigurinë e ushqimit, si dhe ushtron kompetencat e tij ligjore në rastet e konstatimit të shkeljeve. Në rastet kur evidentohen problematika që lidhen me sigurinë ushqimore, institucioni ynë ndërhyn në përputhje me kompetencat ligjore, ndërsa bashkia dhe strukturat arsimore angazhohen për adresimin e çështjeve që lidhen me përgjegjësitë e tyre. Ky bashkëpunim synon garantimin e ushqimit të sigurt dhe mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve. Theksojmë se, në bashkëpunim me bashkitë, janë zhvilluar takime informuese dhe këshilluese lidhur me kushtet higjieno-sanitare të kuzhinave, si dhe nevojën për forcimin e kritereve të prokurimit për produktet ushqimore, veçanërisht ato me origjinë shtazore, duke garantuar gjurmueshmërinë dhe dokumentacionin përkatës.			
128.	07.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me kërkesat dhe dokumentacionin e nevojshëm për importimin e një kafshe shtëpiake (mace) nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Shqipërisë, përmes transportit ajror. Konkretisht, subjekti kërkon të informohet nëse, për një mace të vaksinuar kundër tërbimit, është e mjaftueshme një Certifikatë	Urdhri nr.634, datë 02.11.2023 "*Për miratimin e Rregullores mbi lëvizjen jo-komerciale të kafshëve shoqëruese*" i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka miratuar Rregulloren përkatëse e cila përcakton kërkesat shëndetësore për kafshët shoqëruese që zbatohen për lëvizjen jo-komerciale të tyre; rregullat për kontrollin e këtyre lëvizjeve; si dhe dokumentacionin e nevojshëm. *Subjektit të interesuar, i vendoset në dispozicion dokumentacioni i lartpërmendur.*	20.10.2026	e plotë	nuk ka

			Shëndetësore Veterinare dygjuhëshe, e nënshkruar nga një veteriner zyrtar, apo kërkohet një Certifikatë Shëndetësore për Eksport (Export Health Certificate – EHC) dhe, në këtë rast, cila është certifikata përkatëse që duhet të përdoret. *Shënim: Kërkesa për informacion është dërguar në gjuhën angleze.*				
129.	08.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me të dhënat e mëposhtme: • Përgjatë viteve 2024, 2025 dhe 9 mujori i vitit 2026, sa kg mish i egër *(pra, nga kafshë të egra)* është importuar nga Turqia (me origjinë Turqi) dhe është futur në territorin e Republikës së Shqipërisë?	Nga verifikimet e kryera dhe informacionet e përcjella nga Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, rezulton se nuk ka importe nga Turqia për produktin mish i egër (nga kafshë të egra) për periudhën: vitet 2024-2025 dhe Janar-Shtator 2026.	20.10.2026	e plotë	nuk ka
130.	09.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti është përzgjedhur për të marrë pjesë në Panairin e verës në Shangai. Me qëllim vijimin e procedurës së dërgimit të shisheve të verës në këtë panair, subjekti kërkon pajisjen me dokumentacionin përkatës nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, me qëllim eksportimin e shisheve të verës, të cilat konkretisht janë në procedurë eksporti për mostrat.	Detyrimi i regjistrimit të ndërmarrjeve të huaja prodhuese të produkteve ushqimore që eksportohen drejt Kinës zbatohet prej datës 01 Janar 2022. Aktualisht, kjo procedurë rregullohet nga Rregullorja nr.280 e Administratës së Përgjithshme të Doganave të Kinës (GACC), në fuqi nga data 01 Qershor 2026, dhe kërkesat përkatëse të zbatimit të saj. **Për verërat, regjistrimi kryhet nëpërmjet aplikimit të drejtpërdrejtë nga vetë subjekti në sistemin kinez China Import Food Enterprises Registration (CIFER), i aksesueshëm në adresën: https://cifer.singlewindow.cn/**	14.10.2026	e plotë	nuk ka

				Subjekti duhet të krijojë llogarinë, të përzgjedhë kategorinë përkatëse të produktit dhe të plotësojë vetë të dhënat e kërkuara për ndërmarrjen, njësinë prodhuese e produktet. Gjithashtu, subjekti ngarkon drejtpërdrejt në sistem dokumentacionin e kërkuar, dorëzon aplikimin dhe ndjek ecurinë e shqyrtimit, duke përfshirë plotësimet / sqarimet që mund të kërkohen nga autoritetet kineze. Për këtë procedurë regjistrimi, referuar produktit verë, nuk kërkohet paraqitja e dokumentacionit pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe as rekomandimi i subjektit nga institucioni ynë. Kërkesat konkrete, formularët dhe dokumentet që duhen ngarkuar përcaktohen në sistemin CIFER sipas kategorisë dhe klasifikimit të produktit. Regjistrimi miratohet nga autoriteti kompetent kinez; *krijimi i llogarisë ose dorëzimi i aplikimit nuk përbën në vetvete miratim të regjistrimit*. Sqarojmë se, pavarësisht se dërgesa përmban një sasi të vogël produktesh dhe synohet të përdoret si mostër për panair, dërgimi i tyre drejt Kinës konsiderohet eksport produktesh. Sasia e kufizuar dhe qëllimi promovues nuk përbëjnë në vetvete, përjashtim nga kërkesat e zbatueshme për hyrjen e produkteve ushqimore në Kinë. Për rrjedhojë, duhet ndjekur procedura e regjistrimit dhe përmbushjes së kërkesave në sistemin CIFER. Paralelisht, në bashkëpunim me organizatorin e panairit ose subjektin pritës në Kinë, duhet të konfirmohen kërkesat për dokumentacionin shoqërues, etiketimin dhe formalitetet doganore të dërgesës, duke specifikuar përdorimin e produkteve për ekspozim ose degustim dhe çdo procedurë të posaçme që mund të zbatohet.			

131.	12.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me prodhimin e ushqimit në kuzhinën e shtëpisë, me qëllim shitjen e tij në dyqane (si sipërmarrës i huaj). *Shënim: Kërkesa për informacion është dërguar në gjuhën angleze.*	Prodhimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore përbëjnë veprimtari që duhet të ushtrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore, regjistrimin e veprimtarisë ekonomike dhe kërkesat higjieno-sanitare për ambientin ku përpunohet ushqimi. Çdo subjekt që kryen veprimtari me natyrë ekonomike jovetjake në fushën e ushqimit, "*prodhim dhe/ose tregtim të ushqimeve*", duhet të **regjistrohet** dhe **licencohet** sipas legjislacionit në fuqi. Një subjekt i cili ka përfunduar regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në fushën e ushqimit, është i detyruar të njoftojë Drejtorinë Rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU), për vendin e kryerjes së aktivitetit dhe natyrën e tij, jo më vonë se 30 *(tridhjetë)* ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë. Subjektet që kryejnë veprimtari tregtuese të produkteve me natyrë joshtazore, si dhe subjektet që kryejnë veprimtari me pakicë, nuk e kanë detyrim ligjor pajisjen me licencë. Nëse subjekti kryen aktivitet me shumicë të produkteve me origjinë shtazore, është i detyruar të bëjë aplikimin për pajisje me licencë pranë QKB-së, të cilin mund ta bëjë online në portalin '*e-Albania*', ku lista me dokumentet provuese që duhet të paraqesë është e publikuar në faqen zyrtare të QKB-së. Në lidhje me vendin dhe natyrën e aktivitetit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ushtron kontrollin në vend për verifikimin e plotësimit të	20.10.2026	e plotë	nuk ka

				kushteve dhe kritereve, sipas legjislacionit në fuqi. Është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor (OBU) që përgatit, përpunon, prodhon, ruan dhe shpërndan produkte ushqimore në mjedise të ushtrimit të aktivitetit me pakicë apo shumicë, të sigurojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, rregullave dhe standardeve të detyrueshme tekniko-teknologjike në ambientet e tij, si dhe dokumentacion të rregullt të produkteve ushqimore sipas këtij legjislacioni: • Ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*; • Ligjin nr.99/2024 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*"; • VKM-në nr.434, datë 11.07.2018 "*Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit*"; • VKM-në nr.760, datë 16.09.2015 "*Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor*"; • Udhëzimin nr.22, datë 25.11.2010 "*Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimorë*"; • Udhëzimin nr.20, datë 25.11.2010 "*Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimentet ushqimore*".			

				Personeli që do të punojë në subjektin në fjalë duhet të pajiset me këtë dokumentacion: librezë shëndetësore, të detyrueshme për çdo person i cili është pjesë e personelit që punon në fushën e trajtimit apo shitjes së ushqimit, si dhe analizën e ujit për ngarkesën mikrobiologjike. Gjithashtu, çdo operator biznesi ushqimor duhet të plotësojë: • Vendndodhjen, kushtet dhe gjendjen e stabilimentit, planimetrinë e prodhimit, zyrat, mjedisin, mjetet e transportit (nëse bën transport). • Kushtet higjieno-sanitare të prodhimit, librezat shëndetësore. • Lëndët e para, ujin, shtesat teknologjike (dokumentacion shoqërues). • Mënyrën e paketimit dhe materialet paketuese. • Etiketimin dhe dokumentet shoqëruese të lëndëve të para dhe produktit përfundimtar. • Proceset teknologjike që zbatohen në prodhim/përpunim. • Drejtuesin teknik (në rast se kryen aktivitet me shumicë në prodhim) ose personin përgjegjës për sigurinë ushqimore (shitje/shpërndarje). • Planin HACCP. • Gjurmueshmërinë. • Planin 3D (planin e brejtësve dhe insekteve).			

132.	12.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me procedurat, lejet, licencat dhe çdo dokumentacion tjetër që nevojitet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, me qëllim nisjen e aktivitetit tregtar *supermarket* (me shënimin: dyqan jo i specializuar, që do të tregtojë artikuj ushqimorë, fruta-perime, të kategorizuar në kategorinë "47.11").	Çdo subjekt që ushtron veprimtari me natyrë ekonomike jovetjake në fushën e ushqimit, konkretisht në prodhimin dhe/ose tregtimin e ushqimeve, duhet të **regjistrohet** dhe kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të pajiset me **licencën** përkatëse. Subjekti që ka përfunduar regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me objekt veprimtarie në fushën e ushqimit dhe me kategorinë e aktivitetit "Supermarket", është i detyruar të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) për vendin ku ushtrohet veprimtaria dhe natyrën e saj, jo më vonë se 30 *(tridhjetë)* ditë nga fillimi i veprimtarisë së tregtimit me pakicë. **Subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtimi të produkteve me origjinë joshtazore, si dhe subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtimi me pakicë, nuk kanë detyrimin ligjor për t'u pajisur me licencë**. Ndërsa, në rastet kur subjekti ushtron veprimtari të tregtimit me shumicë të produkteve ushqimore me origjinë shtazore, ai është i detyruar të aplikojë pranë QKB-së për pajisjen me licencën përkatëse. Aplikimi mund të kryhet *online*, ndërsa lista e dokumenteve provuese që duhet të paraqiten është e publikuar në faqen zyrtare të QKB-së. **Nënkategoria (Kodi II.1.B): Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)** zbatohet vetëm për produktet ushqimore me origjinë shtazore, pra në rastet kur subjekti ushtron veprimtari tregtimi të këtyre produkteve.	13.10.2026	e plotë	nuk ka

				Në lidhje me vendin dhe natyrën e veprimtarisë, AKU ushtron kontrolle në vend, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor (OBU), që përgatit, përpunon, prodhon, ruan ose shpërndan produkte ushqimore në mjediset ku ushtron veprimtarinë e tij, me pakicë apo me shumicë, të sigurojë zbatimin rigoroz të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, të rregullave dhe standardeve të detyrueshme tekniko-teknologjike në ambientet e aktivitetit, si dhe mbajtjen e dokumentacionit të rregullt për produktet ushqimore, në përputhje me legjislacionin përkatës, konkretisht: • Ligji nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*"; • Ligji nr.99/2024 "*Për inspektimin në RSH*"; • VKM nr.434, datë 11.07.2018 "*Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit*"; • VKM nr.760, datë 16.09.2015 "*Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor*"; • Udhëzimi nr.22, datë 25.11.2010 "*Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor*"; *dhe* • Udhëzimi nr.20, datë 25.11.2010 "*Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimentet ushqimore*".			

				Personeli që do të punojë në subjekt duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin përkatës, konkretisht me librezë shëndetësore, e detyrueshme për çdo person që është pjesë e personelit dhe që punon në fushën e trajtimit ose të shitjes së ushqimeve, si dhe me analizën e ujit për përcaktimin e ngarkesës mikrobiologjike. Gjithashtu, çdo OBU duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme: • Të sigurojë vendndodhjen, kushtet dhe gjendjen e stabilimentit, planimetrinë e mjediseve të prodhimit dhe të zyrave, si dhe kushtet e mjeteve të transportit, në rastet kur ushtron veprimtari transporti; • Të përmbushë kushtet higjieno-sanitare të prodhimit dhe të sigurojë pajisjen e personelit me librezat shëndetësore përkatëse; • Të disponojë dokumentacionin shoqërues për lëndët e para, ujin dhe shtesat teknologjike; • Të përcaktojë mënyrën e paketimit dhe të sigurojë përputhshmërinë e materialeve të paketimit me kërkesat përkatëse; • Të sigurojë etiketimin e produkteve dhe dokumentacionin shoqërues të lëndëve të para dhe të produktit përfundimtar; • Të dokumentojë proceset teknologjike që zbatohen gjatë prodhimit dhe/ose përpunimit; • Të sigurojë drejtues teknik, në rastet kur kjo kërkohet për veprimtarinë e ushtruar, përfshirë veprimtarinë e prodhimit me shumicë; • Të hartojë dhe zbatojë planin HACCP; • Të sigurojë gjurmueshmërinë e produkteve; • Të hartojë dhe zbatojë planin 3D (plani brejtësve dhe insekteve).			

133.	13.10.2026	Kërkesë për punësim	Subjekti shpreh interesin për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Elbasan.	Vendet vakante të institucionit publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në web-in: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit *(www.aku.gov.al)*, seksioni '*Rreth Nesh*' > '*Mundësi punësimi*' > '*Shpallje për vende të lira pune*' ***dhe/ose*** në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm **(për pozicionet me funksione inspektuese)**, në web-in: Inspektorati i Përgjithshëm *(https://ip.gov.al/)*. Çdo shpallje e pozicioneve vakante përmban informacionin e duhur dhe të plotë në lidhje me pozicionin e lirë, sektorin dhe drejtorinë përkatëse, kategorinë e pagës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta mbi arsimin, përvojën, etj., si dhe rregullat mbi afatin, mënyrën e dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionit të kërkuar.	14.10.2026	e plotë	nuk ka
134.	14.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar është shtetas australian dhe po zhvendoset përgjithmonë në Tiranë, Shqipëri, së bashku me dy macet shoqëruese. Macet do të udhëtojnë me të si lëvizje jo komerciale (jo për shitje apo transferim pronësie). Departamenti i Bujqësisë, Peshkimit dhe Pylltarisë së Australisë (DAFF) do të lëshojë certifikatën shëndetësore të eksportit. Megjithatë, DAFF pranon vetëm kërkesat e importit të lëshuara nga qeveria e vendit importues, prandaj ka nevojë për	Urdhri nr.634, datë 02.11.2023 "*Për miratimin e Rregullores mbi lëvizjen jo-komerciale të kafshëve shoqëruese*" i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka miratuar Rregulloren përkatëse e cila përcakton kërkesat shëndetësore për kafshët shoqëruese që zbatohen për lëvizjen jo-komerciale të tyre; rregullat për kontrollin e këtyre lëvizjeve; si dhe dokumentacionin e nevojshëm. *Subjektit të interesuar, i vendoset në dispozicion dokumentacioni i lartpërmendur.*	20.10.2026	e plotë	nuk ka

			një konfirmim me shkrim nga autoritetet shqiptare. Konkretisht: 1. Kërkesat zyrtare për lëvizjen jo komerciale të maceve shoqëruese nga Australia në Republikën e Shqipërisë; 2. Modelin zyrtar të certifikatës shëndetësore që Shqipëria kërkon për këtë qëllim (në versionin dygjuhësh shqip/anglisht); 3. Konfirmimin që, duke qenë se Australia është e renditur në Shtojcën II të Rregullores Zbatuese (BE) nr.577/2013, testi i titrimit të antitrupave të tërbimit nuk kërkohet; 4. Konfirmimin që nuk kërkohet leje importi.				
135.	16.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me shoqërinë "Z*****" SHPK, konkretisht, përgjatë periudhës Janar 2020 - Shtator 2026: 1. Sa është sasia totale *(në kg ose ton)* e produkteve të skaduara që ky subjekt ka asgjësuar? 2. Lutem të saktësoni datën, muajin *dhe* vitin se kur janë kryer procedurat e asgjësimit. 3. Sa inspektime (të programuara dhe/ose të paprogramuara) janë kryer nga AKU përgjatë kësaj periudhe dhe cilat kanë qenë gjetjet kryesore?	Nga verifikimet e kryera lidhur me subjektin tregtar "Z*****" SHPK, rezulton se për periudhën e kërkuar (Janar 2020 – Shtator 2026), **ky subjekt nuk ka patur procedura asgjësimesh për produkte të skaduara**. Gjatë kësaj periudhe, **rezulton se pranë subjektit janë kryer në total 21 *(njëzet e një)* inspektime**, nga të cilat 11 *(njëmbëdhjetë)* inspektime të programuara *dhe* 10 *(dhjetë)* inspektime të kryera jashtë programit. Gjatë inspektimeve të kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pranë subjektit, **nuk janë konstatuar problematika**.	26.10.2026	e plotë	nuk ka

136.	22.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me shoqërinë "B****" SHPK, konkretisht, përgjatë periudhës Janar 2020 - Shtator 2026: 1. Sa është sasia totale *(në kg ose ton)* e produkteve të skaduara që ky subjekt ka asgjësuar? 2. Lutem të saktësoni datën, muajin *dhe* vitin se kur janë kryer procedurat e asgjësimit. 3. Sa ka qenë sasia përkatëse e asgjësuar për çdo procedurë? 4. Sa inspektime (të programuara dhe/ose të paprogramuara) janë kryer nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit përgjatë kësaj periudhe dhe cilat kanë qenë gjetjet kryesore?	Nga verifikimet e kryera lidhur me subjektin tregtar "B****" SHPK, rezulton se për periudhën e kërkuar (Janar 2020 – Shtator 2026), **<u>ky subjekt nuk ka pasur procedura asgjësimesh për produkte të skaduara</u>**. ***Në përgjigje të pyetjes së fundit***, nga verifikimet e kryera, rezulton se përgjatë periudhës Janar 2020 – Shtator 2026, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka ushtruar pranë subjektit, inspektimet e mëposhtme: • **Viti 2020**: 5 *(pesë)* inspektime të programuara; • **Viti 2021**: 11 *(njëmbëdhjetë)* inspektime gjithsej, nga të cilat 10 *(dhjetë)* të programuara dhe 1 *(një)* inspektim i paprogramuar; • **Viti 2022**: 14 *(katërmbëdhjetë)* inspektime gjithsej, nga të cilat 12 *(dymbëdhjetë)* të programuara dhe 2 *(dy)* të paprogramuara; • **Viti 2023**: 12 *(dymbëdhjetë)* inspektime të programuara; • **Viti 2024**: 16 *(gjashtëmbëdhjetë)* inspektime gjithsej, nga të cilat 12 *(dymbëdhjetë)* të programuara dhe 4 *(katër)* të paprogramuara. • **Viti 2025**: 15 *(pesëmbëdhjetë)* inspektime gjithsej, nga të cilat 13 *(trembëdhjetë)* të programuara dhe 2 *(dy)* të paprogramuara; *dhe* • **Viti 2026**: 2 *(dy)* inspektime të paprogramuara. Inspektimet e programuara janë kryer në bazë të Planit Zyrtar të Inspektimeve *për subjektet me bazë risku të lartë*, si dhe në zbatim të Planit Zyrtar *të marrjes së mostrave për produktin vezë*, për analizimin e pranisë së "*Salmonella*".	02.11.2026	e plotë	nuk ka

				Sa u përket inspektimeve të paprogramuara, ato janë kryer për arsyet e mëposhtme: • **Viti 2021**: Inspektimi i paprogramuar është kryer në kuadër të planit të monitorimit; • **Viti 2022**: Dy inspektimet e paprogramuara janë kryer si rezultat i një njoftimi "ALERT" dhe njoftimeve nëpërmjet sistemit "RASFF"; • **Viti 2024**: Inspektimet e paprogramuara janë kryer për shkak të një indicie të ardhur nëpërmjet postës elektronike, për zhbllokimin e produktit me destinacion "*kthim në origjinë*", me kërkesë të subjektit, si dhe për zhbllokimin e produktit pas rezultatit negativ të analizave laboratorike; • **Viti 2025**: Inspektimet e paprogramuara janë kryer në zbatim të Urdhrit nr.686, datë 10.09.2024, si dhe në përgjigje të kërkesës së subjektit për licencim; • **Viti 2026**: Inspektimet e paprogramuara janë kryer në përgjigje të kërkesës së subjektit për licencim. Gjatë inspektimeve të ushtruara, janë konstatuar problematika kryesisht për praninë e materialeve të panevojshme në ambiente, nevojën për sistemimin e ambientit të magazinimit dhe rinovimin e librezave shëndetësore të punonjësve. Lidhur me këto konstatime, janë marrë masa paralajmërimi. Po kështu, nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, janë kryer bllokime produktesh, të cilat janë zhbllokuar pas daljes së rezultateve të analizave laboratorike, të cilat kanë konfirmuar se produktet ishin *konforme*.			

137.	23.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion se sa inspektime / monitorime janë kryer nga trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, përgjatë viteve 2024, 2025 *dhe* 2026, tek Operatorët e Biznesit Ushqimor (OBU) të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambalazhimin, shpërndarjen apo tregtimin e fasuleve në tregun e shumicës dhe pakicës, lidhur me verifikimin e detyrimit ligjor për deklarimin e saktë të vendit të origjinës në etiketë? 1. Sa masa administrative (gjoba, pezullime, ose bllokim produkti) janë ndërmarrë ndaj subjekteve për shkelje të nenit të mashtrimit me origjinën (p.sh. tregtim i fasules së importit nën emërtimin e prodhimit vendas)? Lutem të na vini në dispozicion vlerën totale të gjobave dhe listën e subjekteve të penalizuara. 2. Sa ngarkesa me fasule të importuara nga vende jashtë Bashkimit Europian (BE) janë analizuar në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) përgjatë 3 *(tre)* viteve të fundit dhe sa prej tyre janë refuzuar/kthyer ose asgjësuar për shkak të ngarkesës mikrobike, pranisë së parazitëve ose tejkalimit të normave	***Në përgjigje të pyetjes së parë***, sqarojmë se referuar detyrimit të Operatorit të Biznesit Ushqimor (OBU-së) për deklarimin e vendit të origjinës në etiketën e produkteve ushqimore, bazuar në legjislacionin në fuqi, <u>ky detyrim nga ana e OBU-së do të lindë në momentin që Shqipëria do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (BE)</u>. Konkretisht, në nenin 41, pika 3, të VKM-së nr.434, datë 11.07.2018 "*Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit*", citohet se: "*Pikat 2, shkronjat 'b', 'c', 'ç', 'd', 'dh', 'e', 'f', 'g' dhe 3, të nenit 26, të këtij vendimi, zbatohen drejtpërdrejt me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian*". Po kështu, neni 26 "*Shteti i origjinës ose vendi i prejardhjes*", pikat 2 dhe 3, i po kësaj VKM-je, përcakton se: "*2. Deklarimi i shtetit të origjinës ose i vendit të prejardhjes është i detyrueshëm: b) Për mishin që përfshihet në kodet (CN) të Nomenklaturës së Kombinuar, të renditur në shtojcën XI; c) Për llojet e mishit të ndryshme nga mishi i viçit dhe ato të përmendura në shkronjën 'b', të pikës 2; ç) Për qumështin; d) Për qumështin e përdorur si përbërës në produktet e bulmetit; dh) Për produktet ushqimore të papërpunuara; e) Për produktet me një përbërës të vetëm; ë) Për përbërësit që përfaqësojnë mbi 50% të produktit ushqimor; f) Për përdorimin e mishit si përbërës. 3. Në rastin kur vendi i origjinës ose vendi i prejardhjes së një produkti ushqimor deklarohet dhe nuk është i njëjtë me atë të përbërësit kryesor [...]*".	04.11.2026	e plotë	nuk ka

			maksimale të mbetjeve të pesticideve (MRL)?	Nga verifikimet e kryera, rezulton se në OBU-të me veprimtari paketim/ambalazhim dhe tregtim me shumicë të fasuleve, përgjatë viteve 2024–2026, janë kryer gjithsej **52** ***(pesëdhjetë e dy)*** **inspektime**. Nga këto inspektime, **nuk janë konstatuar shkelje lidhur me deklarimin e vendit të origjinës në etiketë**. ***Në përgjigje të pyetjes së dytë***, sikurse më lart sqaruar, përgjatë periudhës 2024–2026, **nuk janë marrë masa administrative (gjoba, pezullime veprimtarie apo bllokime produkti) ndaj subjekteve për shkelje që lidhen me mashtrimin me origjinën e fasules**, pasi në inspektimet e kryera nuk janë konstatuar raste të tilla. ***Në përgjigje të pyetjes së fundit***, nga verifikimet e kryera në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK), përgjatë viteve 2024–2026, rezulton se **janë analizuar gjithsej 31** ***(tridhjetë e një)*** **ngarkesa me fasule të importuara nga vende jashtë Bashkimit Europian, të cilat kanë rezultuar të gjitha konform**. Përgjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë ngarkesë me fasule të refuzuar, të kthyer apo të asgjësuar për shkak të ngarkesës mikrobike, pranisë së parazitëve apo tejkalimit të normave maksimale të mbetjeve të pesticideve (MRL).			

138.	26.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar ushtron aktivitet tregtar në fushën e prodhimit dhe shërbimit ushqimor. Në këtë kuadër, subjekti kërkon informacion mbi kërkesat ligjore dhe procedurat administrative për importin e mishit, nënprodukteve të tij dhe produkteve ushqimore të ngrira nga vendet e Bashkimit Evropian (BE). Produktet synohen të importohen për përdorim si lëndë të para në proceset e përgatitjes dhe prodhimit ushqimor të shoqërisë, pa u tregtuar drejtpërdrejt në gjendjen e importuar. Në këtë kuadër, kërkojmë informacion mbi: 1. Regjistrimet, licencat, miratimet apo autorizimet që duhet të disponojë shoqëria për kryerjen e këtij aktiviteti; 2. Procedurat që duhet të ndiqen përpara importit dhe gjatë hyrjes së ngarkesave në territorin e Republikës së Shqipërisë 3. Dokumentacionin e detyrueshëm që duhet të shoqërojë produktet, përfshirë certifikatat veterinare, shëndetësore apo dokumente të tjera, sipas kategorisë përkatëse 4. Kërkesat për miratimin e furnitorëve dhe stabilimenteve	***Në përgjigje të pyetjes së parë***, nga verifikimet e kryera, rezulton se shoqëria disponon licencat e mëposhtme: • **Licenca nr.LN-****-**-2024**, me objekt veprimtarie: "*Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)*"; • **Licenca nr.LN-****-**-2026**, me objekt veprimtarie: "*Prodhim, përpunim dhe shpërndarje të ushqimeve, restorant, mensë, snack food, prodhime brumi dhe pastiçerie, shërbime kateringu*". Në këtë kuadër, informojmë se në bazë të objektit të veprimtarisë së përcaktuar në licencat e mësipërme, shoqëria mund të ushtrojë aktivitetet përkatëse, në përputhje me fushën e veprimtarisë së secilës licencë dhe me kërkesat ligjore në fuqi. Konkretisht, **në kuadër të licencës nr. LN-****-**-2026, importi i mishit mund të kryhet për nevojat e aktivitetit të restorantit**, si lëndë e parë për përgatitjen e ushqimeve, dhe jo për tregtimin e tij të drejtpërdrejtë në gjendjen e importuar, në përputhje me kushtet dhe kërkesat ligjore përkatëse. Ndërsa, **në kuadër të licencës nr.LN-****-**-2024, importi i mishit në këtë rast bëhet me objekt shitjen me shumicë**. ***Në përgjigje të pyetjes së dytë***, importi i mishit dhe i produkteve me origjinë shtazore, i nënshtrohet kërkesave të ligjit nr.9868, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" (i ndryshuar), si dhe legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve e kontrollin zyrtar.	05.11.2026	e plotë	nuk ka

			prodhuese, si dhe kufizimet e mundshme sipas produktit dhe vendit të origjinës 5. Kushtet që duhet të përmbushen për transportin, ruajtjen e zinxhirit të ftohtë, magazinimin, etiketimin dhe gjurmueshmërinë 6. Ekzistencën e kërkesave të veçanta për importin e këtyre produkteve për përdorim në prodhimin e vetë shoqërisë 7. Lutem që përgjigjja e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të përfshijë referencat përkatëse të legjislacionit në fuqi dhe orientimin pranë strukturave kompetente për ndjekjen e procedurave.	Përpara realizimit të importit, Operatori i Biznesit Ushqimor (OBU) duhet të sigurohet që produktet që synon të importojë, përmbushin kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve, si dhe kushtet specifike të përcaktuara për kategorinë përkatëse të produkteve. Për këtë qëllim, OBU: • duhet të jetë i regjistruar dhe i pajisur me licencat përkatëse për ushtrimin e aktivitetit të biznesit ushqimor, sipas legjislacionit në fuqi; • duhet të verifikojë lejueshmërinë e importit të produktit nga vendi i origjinës dhe përmbushjen e kushteve shëndetësore dhe veterinare të përcaktuara për produktin përkatës; • duhet të sigurojë që ngarkesa të shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar veterinar dhe dokumentacionin tjetër shoqërues; • duhet të njoftojë paraprakisht strukturën kompetente në pikën e inspektimit kufitar (pik), sipas procedurave të përcaktuara për kontrollin e ngarkesave. Në momentin e mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, ngarkesat duhet të paraqiten në Pikën e Inspektimit Kufitar (PIK) përkatëse, ku i nënshtrohen kontrolleve zyrtare, përfshirë kontrollin dokumentar, verifikimin e identitetit dhe kontrollin fizik, sipas kërkesave. Procedurat doganore për përfundimin e importit kryhen pas përfundimit të kontrolleve përkatëse dhe dhënies së miratimit nga autoriteti kompetent. ***Në përgjigje të pyetjes së tretë***, dokumentacioni që duhet të shoqërojë ngarkesën, përcaktohet në varësi të natyrës, kategorisë dhe destinacionit.			

				Kështu, për mishin dhe produktet me origjinë shtazore, dokumentacioni duhet të përfshijë, sipas rastit: • Certifikatën zyrtare veterinare/shëndetësore, të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues, sipas modelit të zbatueshëm për kategorinë përkatëse të produktit; • Dokumentin tregtar (faturë), si dhe dokumentacionin e transportit; • Të dhëna për identifikimin e produktit, përfshirë përshkrimin, sasinë, lotin dhe vendin e origjinës. Për sa më sipër, theksojmë se kërkesa për pajisjen me certifikatë shëndetësore veterinare zbatohet për produktet për të cilat legjislacioni parashikon detyrimin e certifikimit veterinar, në përputhje me kategorinë dhe destinacionin e tyre. ***Në përgjigje të pyetjes së katërt***, importi i mishit dhe produkteve me origjinë shtazore lejohet vetëm nëse përmbushen kërkesat përkatëse të shëndetit të kafshëve dhe sigurisë ushqimore. Në këtë kuadër, duhet të garantohet që: • vendi i origjinës të jetë i pranueshëm për eksportin e kategorisë përkatëse të produkteve; • stabilimenti prodhues, përpunues ose frigoriferik nga i cili vjen produkti të jetë i miratuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues dhe të përmbushë kërkesat përkatëse për eksport; • produktet të jenë prodhuar, përpunuar, ruajtur dhe certifikuar në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse;			

				• të mos ketë masa kufizuese ose ndalime të vendosura për shkak të situatës epidemiologjike apo të rreziqeve të tjera për shëndetin e kafshëve dhe sigurinë ushqimore. *Lejueshmëria e importit vlerësohet për çdo kategori produkti dhe vend origjine, pasi mund të ekzistojnë kufizime specifike për lloje të caktuara mishi, nënproduktesh ose produkte të tjera me origjinë shtazore!* ***Në përgjigje të pyetjes së pestë***, magazinimi, transporti, ruajtja, etiketimi dhe gjurmueshmëria e mishit, nënprodukteve të tij dhe produkteve ushqimore të ngrira, duhet të kryhen në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*, si dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij, konkretisht: ***Sa i përket transportit dhe ruajtjes së zinxhirit të ftohtë***, referuar Udhëzimit nr.22, datë 25.11.2010 "*Për kushte të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor*", Shtojca II, Kapitulli IV, mjetet e transportit dhe kontejnerët e përdorur për transportimin e produkteve ushqimore duhet të jenë të përshtatshëm, të pastër, të mirëmbajtur dhe të mundësojnë ruajtjen e produkteve në temperaturat e kërkuara, si dhe monitorimin e tyre. OBU duhet të garantojë vazhdimësinë e zinxhirit të ftohtë gjatë transportit, shkarkimit, magazinimit e përpunimit të produkteve, duke shmangur ndërprerjet që mund të cenojnë sigurinë ushqimore.			

				Për mishin dhe produktet e mishit zbatohen gjithashtu kërkesat specifike të Udhëzimit nr.17, datë 24.09.2021 "*Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike*". Në varësi të kategorisë së produktit, duhet të respektohen temperaturat përkatëse të ruajtjes dhe transportit. Për mishin e freskët të thundrakëve shtëpiakë parashikohen temperatura jo më të larta se +7°C për mishin dhe +3°C për rropullitë, ndërsa për mishin e ngrirë zbatohet, si rregull, ruajtja në temperaturë -18°C ose më të ulët. Për kategori të tjera produktesh zbatohen kërkesat specifike të përcaktuara në legjislacionin përkatës. ***Sa i përket magazinimit***, ambientet duhet të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare, të disponojnë kapacitete frigoriferike të përshtatshme dhe të mundësojnë kontrollin e temperaturave, mbrojtjen nga kontaminimi dhe ndarjen e produkteve sipas natyrës dhe karakteristikave të tyre. Në përputhje me Shtojcën II, Kapitullin IX, të Udhëzimit nr.22/2010, lëndët e para dhe përbërësit ushqimorë duhet të ruhen në kushte që parandalojnë prishjen dhe kontaminimin. Shkrirja e produkteve të ngrira, duhet të kryhet në kushte të kontrolluara, duke minimizuar rrezikun e zhvillimit të mikroorganizmave patogjenë. ***Sa i përket etiketimit***, zbatohen përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr.434, datë 11.07.2018 "*Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit*".			

				Informacioni ushqimor duhet të jetë i saktë dhe të mundësojë identifikimin e produktit, përbërjes, origjinës, afatit të përdorimit, kushteve të ruajtjes dhe të dhënave të tjera të detyrueshme sipas kategorisë përkatëse. Për produktet ushqimore të importuara, informacioni i detyrueshëm ushqimor duhet të jepet në gjuhën shqipe, sipas kërkesave të zbatueshme të këtij vendimi. Në rastin kur produktet importohen si lëndë të para për përpunim dhe jo për tregtim të drejtpërdrejtë te konsumatori, duhet të garantohet disponueshmëria e informacionit të nevojshëm për identifikimin, përdorimin e sigurt dhe gjurmueshmërinë e tyre, duke respektuar kërkesat e etiketimit dhe informimit që zbatohen për kategorinë përkatëse. ***Sa i përket gjurmueshmërisë***, në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)* dhe VKM-në nr.760, datë 16.09.2015 "*Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor*", OBU ka detyrimin të krijojë dhe të zbatojë një sistem funksional *gjurmueshmërie*, i cili mundëson identifikimin e furnizuesve, origjinës së produkteve, ngarkesave dhe loteve, si dhe përdorimin e lëndëve të para në procesin e prodhimit. Gjithashtu, OBU duhet të zbatojë *procedurat e vetëkontrollit*, të bazuara në parimet e sistemit "HACCP", sipas nenit 26 të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)* dhe Udhëzimit nr.20, datë 25.11.2010.			

				Në përgjigje të pyetjes së fundit, fakti që produktet importohen për t'u përdorur si lëndë e parë në proceset e përgatitjes dhe prodhimit ushqimor të vetë shoqërisë, dhe jo për t'u tregtuar drejtpërdrejt në gjendjen në të cilën importohen, nuk përbën përjashtim nga kërkesat ligjore për importin dhe kontrollin zyrtar. Për rrjedhojë, produktet duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa bazë për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve, dokumentacionin shoqërues, *gjurmueshmërinë* dhe kushtet e ruajtjes e transportit, sipas kategorisë përkatëse. Gjithashtu, OBU duhet të garantojë që stabilimentet ku do të përdoren këto produkte të përmbushin kërkesat e legjislacionit në fuqi për higjienën e produkteve ushqimore, sistemin e vetëkontrollit të bazuar në parimet 'HACCP' dhe *gjurmueshmërinë* e lëndëve të para e produkteve të përftuara. Në përfundim, për përcaktimin e saktë të kërkesave dhe dokumentacionit për secilin produkt, është e nevojshme që shoqëria të paraqesë listën e detajuar të produkteve që synon të importojë, kodet përkatëse tarifore (HS/CN), vendet e origjinës, si dhe destinacionin e përdorimin e tyre teknologjik. Pas administrimit të këtij informacioni, mund të bëhet vlerësimi konkret i kushteve të importit, certifikatave përkatëse dhe çdo kufizimi të mundshëm për produktet dhe vendet e origjinës.			

139.	27.10.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion *lidhur me 28 raste të fruta-perimeve me mbetje pesticidesh mbi normën e lejuar ligjore për vitin 2026, ku në 27 raste produkti ka rezultuar i shitur dhe i konsumuar plotësisht përpara daljes së përgjigjeve të analizave nga laboratori ISUV*, konkretisht: 1. Cili është afati mesatar zyrtar (i shprehur në ditë) që i duhet laboratorit "ISUV", nga momenti i marrjes së mostrës në terren nga inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit deri në nxjerrjen e përgjigjes zyrtare për mbetjet e pesticideve? 2. Mbi çfarë baze ligjore apo procedure standarde operon Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, në kushtet kur mosbllokimi i produktit gjatë kampionimit ka sjellë që në 27 raste pozitive përgjatë vitit 2026, ngarkesat me pesticide mbi normë të rezultojnë të shitura dhe të konsumuara përpara daljes së përgjigjes së analizave? 3. Sa është vlera totale dhe individuale e gjobave të vendosura specifikisht ndaj fermerëve ose pikave të grumbullimit për këto 27 raste të	***Në përgjigje të pyetjes së parë***, në Udhëzimin nr.32, datë 31.12.2025 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "*Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK, për vitin 2026*", pjesë e të cilit është edhe Plani i Monitorimit *të mbetjeve të pesticideve në produktet fruta/perime*, në pikën 7, gërma 'g)', përcaktohet se: "***Afati i analizimit të mostrave të jetë jo më shumë se 15 ditë pune (ndërsa për kontrollet zyrtare 6 ditë pune në kushte normale)***". ***Në përgjigje të pyetjes së dytë***, sqarojmë se, bazuar në Urdhrin e IP (Inspektoratit Qendror) nr.18, datë 23.06.2022 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren 'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ'*", miratuar me Urdhrin nr.25, datë 10.08.2018, Kreu VIII, *marrja e mostrave*, në pikën 37, përcaktohet se: "*Mostrat për analizë merren: a) sipas planit të marrjes së mostrave bazuar në ligjin e posaçëm, referuar metodologjisë së vlerësimit të riskut; b) për rastet kur trupa inspektuese ka dyshim për shkelje të kërkesave ligjore*". Në vijim, neni 38, përcakton se trupa inspektuese, për rastin e parashikuar në shkronjën a), të pikës 37, procedon me mbylljen e Procesverbalit dhe Vendimit Përfundimtar në vendin e inspektimit. Nëse rezultati i ekzaminimit do të rezultojë "*jokonform*", trupa inspektuese inicion **ri-inspektim** *për rezultat 'jokonform' të mostrave të analizuara*.	02.11.2026	e plotë	nuk ka

			përhapjes së ushqimit të pasigurt në treg? 4. Sa është numri i rasteve ku, pas daljes së analizës pozitive në pakicë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer tërheqjen e menjëhershme nga tregu *(recall)* të gjithë pjesës tjetër të sasisë (lotit) që ndodhej ende në magazinat e grumbulluesve të shumicës? 5. Sa raste janë referuar në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë për të shkuar te fermeri/prodhuesi konkret, me qëllim bllokimin e parcelës apo arës që ka prodhuar perimenë me pesticide mbi normë?	Pra, në rastin e Planit të Monitorimit, merret mostër sipas planifikimit (por produkti nuk bllokohet) dhe evidentohet *gjurmueshmëria* sipas faturave përkatëse, me qëllim ndjekjen e furnitorit apo identifikimin e fermerit përgjegjës. Gjithashtu, në nenin 39, përcaktohet se: Trupa inspektuese, për rastin sipas shkronjës b), të pikës 37, e mbyll procesverbalin. Vendimi përfundimtar merret menjëherë pas marrjes së rezultatit të ekzaminimit të mostrës, duke përfunduar Vendimin e Ndërmjetëm. Këtu jemi në rastin kur gjatë kontrollit zyrtar, merren masa të menjëhershme në varësi të rezultatit të analizave *(bllokim produkti, masë administrative etj.)*. ***Në përgjigje të pyetjes së tretë***, lidhje me 27 *(njëzet e shtatë)* rastet kur mostrat kishin rezultuar me mbetje të pesticideve mbi normë, sqarojmë se, masat administrative të mëposhtme janë marrë në OBU (njësi tregtimi dhe magazina shpërndarjeje fruta-perime), pra në subjekte që janë objekt kontrolli nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Ndërsa, *fermat* janë në kompetencën e kontrolleve që kryhen nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), nga Drejtoria Rajonale përkatëse. Në total, janë marrë në 9 *(nëntë)* raste, masa administrative "*Gjobë*" në vlerën totale prej ALL 1,500,000 *(një milion e pesëqind mijëlekë)*, si më poshtë: • ***Në 6 raste***, nga trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ndaj subjektit është marrë masa administrative "*Gjobë*" në vlerën			

				prej ALL 100,000 *(njëqind mijë lekë)*, bazuar në nenin 68, pika 1, gërma (i) e ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*, në lidhje me kërkesat për gjurmueshmërinë të përcaktuara në nenin 25 të po këtij ligji; • ***Në 1 rast***, nga trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ndaj subjektit është marrë masa administrative "*Gjobë*" në vlerën prej ALL 200,000 *(dyqind mijë lekë)*, bazuar në nenin 68, pika 1, gërma (i) e ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*, në lidhje me kërkesat për gjurmueshmërinë të përcaktuara në nenin 25 të po këtij ligji. Po kështu, bazuar në nenin 24, pika 4, u mor masa administrative "*Gjobë*" në vlerën prej ALL 100,000 *(njëqind mijë lekë)*; • ***Në 1 rast***, nga trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ndaj subjektit është marrë masa administrative "*Gjobë*" në vlerën prej ALL 100,000 *(njëqind mijë lekë)*, bazuar në nenin 68, pika 1, gërma (i) e ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*, në lidhje me kërkesat për gjurmueshmërinë të përcaktuara në nenin 25 të po këtij ligji. Po kështu, bazuar në nenin 68, pika 1, gërma (f), në lidhje me përgjegjësitë e operatorit të biznesit, të përcaktuara në nenin 24, pika 4, "*Operatori i biznesit ushqimor duhet t'u japë institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe ministrit përgjegjës për ushqimin informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë e ushqimit*", u mor masa administrative "*Gjobë*" në vlerën prej ALL 100,000 *(njëqind mijë lekë)*;			

				• ***Në 1 rast***, nga trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ndaj subjektit është marrë masa administrative "*Gjobë*" në vlerën prej ALL 100,000 *(njëqind mijë lekë)*, bazuar në nenin 68, pika 1, gërma (i) e ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për Ushqimin*" *(i ndryshuar)*, në lidhje me kërkesat për gjurmueshmërinë të përcaktuara në nenin 25 të po këtij ligji. Po kështu, bazuar në nenin 68, pika 1, gërma (d), në lidhje me kërkesat e sigurisë ushqimore të përcaktuara në nenin 10 të po këtij ligji, ndaj subjektit u mor masa administrative "*Gjobë*" në vlerën prej ALL 300,000 *(treqind mijë lekë)*. ***Në përgjigje të pyetjes së katërt***, në të gjitha rastet, pas daljes së përgjigjes së analizave, produkti ka rezultuar i shitur (gjatë procedurave të monitorimit, produkti nga i cili merret mostra nuk bllokohet, por subjekti ka detyrimin e disponimit të gjurmueshmërisë së produktit). Pra, nuk ka pasur raste të tërheqjes nga tregu. ***Në përgjigje të pyetjes së fundit***, për sa më sipër, në ndjekje të mëtejshme të gjurmueshmërisë tek fermeri furnizues, nga Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) përkatëse, janë përgatitur 16 *(gjashtëmbëdhjetë)* shkresa me lëndë: "*Kërkesë për bashkëpunim*", adresuar për kompetencë, Drejtorive Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të qarkut përkatës, ku ushtron aktivitetin fermeri përgjegjës, si dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të AKVMB-së, Tiranë.			

140.	27.10.2026	Kërkesë për punësim	Subjekti shpreh interesin për punësim pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në pozicionet si: Specialist, Koordinator, Përgjegjës Sektori.	Vendet vakante të institucionit publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në web-in: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit *(www.aku.gov.al)*, seksioni '*Rreth Nesh*' > '*Mundësi punësimi*' > '*Shpallje për vende të lira pune*' ***dhe/ose*** në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm **(për pozicionet me funksione inspektuese)**, në web-in: Inspektorati i Përgjithshëm *(https://ip.gov.al/)*. Çdo shpallje e pozicioneve vakante përmban informacionin e duhur dhe të plotë në lidhje me pozicionin e lirë, sektorin dhe drejtorinë përkatëse, kategorinë e pagës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta mbi arsimin, përvojën, etj., si dhe rregullat mbi afatin, mënyrën e dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionit të kërkuar. Vendet vakante të institucionit publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në web-in: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit *(www.aku.gov.al)*, seksioni '*Rreth Nesh*' > '*Mundësi punësimi*' > '*Shpallje për vende të lira pune*' ***dhe/ose*** në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm **(për pozicionet me funksione inspektuese)**, në web-in: Inspektorati i Përgjithshëm *(https://ip.gov.al/)*. Çdo shpallje e pozicioneve vakante përmban informacionin e duhur dhe të plotë në lidhje me pozicionin e lirë, sektorin dhe drejtorinë përkatëse, kategorinë e pagës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta mbi arsimin, përvojën, etj., si dhe rregullat mbi afatin, mënyrën e dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionit të kërkuar.	30.10.2026	e plotë	nuk ka
141.	29.10.2026	Kërkesë për punësim	Subjekti shpreh interesin për t'u punësuar pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, veçanërisht në strukturat që mbulojnë qarkun Kukës dhe pikën kufitare të Morinës.		30.10.2026	e plotë	nuk ka